

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E ENJTE 14 TETOR 2021

Të nderuar bashkëqytetarë,

Zonja dhe zotërinj, Rasti i refuzimit të komisionit hetimor për çështjen “Beketi” nxjerr përpara opinionit publik frikën e qeverisë për një nga skandalet më të rënda, për të cilin njerëzit e këtij vendi duhet të paguajnë padrejtësisht. Çështja “Beketi” është tipike e qeverive autokratike: goditet media, goditen gazetarët, goditet një sipërmarrës i huaj nga një qeveri cinike, që hakmerret për denoncimin e korrupsionit dhe luksit të zyrtarëve të saj. Për më shumë, qeveria, Kryeministri dhe shërbëtorët e oborrit, me arrogancë u deklaruan shqiptarëve se do e fitonin përballjen në gjykatë dhe se e kishin në xhep fitoren, por, në fakt, shtuan një tjetër faturë të lartë si dhuratë e çmuar për popullin nga një qeveri e korruptuar që e zhyti vendin në një borxh të thellë dhe me politika ekonomike kokë e këmbë të dështuara. Nga e gjithë kjo histori, që sot në një vend tjetër të Bashkimit Europian do ishte e akuzuar dhe të dënuar, në këtë mexhllisn e Kryeministrit është e trishtueshme se si po goditet pa mëshirë nga lista e borxheve të qeverisë shtresa e varfër dhe e mesme në ekonominë e vogël familjare. Asnjë përgjegjësi, veç tallje dhe poshtërim ndaj një populli që me sytë e heshtur e të ftohtë sheh me përbuzje humbëtorë që po ju ndërtoni si arkitektë të vetëm dhe të vërtetë të rrënimit social ekonomik të Shqipërisë.

Të nderuar bashkëqytetarë, Borxhi publik i deklaruar nga Banka e Shqipërisë ka kaluar tashmë 85%. Në fakt, është hera e parë që institucionet shtetërore pranojnë që borxhi ta ketë kapërcyer këtë kufi, ndërkohë që prej disa vjetësh ekspertët e ekonomisë, opozita shqiptare, paralajmërojnë një situatë që mund të dalë jashtë kontrollit për këtë shkak. Borxhi që qeveria u ka subjekteve private për punë publike të realizuar, po t’i shtojmë këtu edhe detyrimin, që llogaritet në rreth 340 milionë euro, gjoba dhe penaltete që Shqipëria ka marrë prej arbitrazheve ndërkombëtare për shkak të kësaj qeverie, sikurse edhe rasti që po shqyrtohet sot “Becchetti”, shifra e borxhit publik rritet frikshëm drejt 100%-shit. Në qarkun e Shkodrës pensionistët, arsimtarët, tregtarët e vegjël, shtresa e varfër dhe e mesme po përballen tashmë me krizën e rëndë: rritjen e çmimeve dhe pasojat e saj. Një grua, para disa ditëve në zonën malore të Shkodrës, pikërisht aty ku Kryeministri i këtij vendi nuk ka shkelur ende, më tregoi për gjendjen e saj të rënduar ekonomike, e cila e siguronte jetesën vetëm me ndihmën e banorëve të tjerë me ushqime. Në betejën e përditshme ajo dhe shumë familje të tjera, si ky rast, kanë vetëm një rrugë: të ikin, të largohen, të ndahen nga ky vend, ku politikat sociale janë veçse në letër, ku strategjitë bëhen vetëm për të grabitur fondet e projekteve nga klientët e qeverisë! Si mund të jetë krenare qeverisja e një vendi si ky yni, ku paga mesatare është më e ulëta në rajon?! Ejani dhe shikoni pak pikat kufitare të Shkodrës çdo fillimjave, herët në mëngjes, se si njerëz të thjeshtë, punëtorë, kalojnë në Malin e Zi për të punuar në ndërtim e bujqësi sepse paguhen disa herë më shumë se në Shqipëri! Vjen në Shkodër “kryeministër-platforma” dhe i duhet ta dëgjojë nga disa nxënës që të rinjtë po largohen për shkak të papunësisë dhe të korrupsionit!